

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakët e Conad Albania sh.p.k. [NUIS: L21423017V]

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Conad Albania sh.p.k. (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një Auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet që pasqyrat të kenë informacion të gabuar me ndikim material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi për ti ardhur ndesh këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë auditimi të njafueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë mbi të cilin të ngrejme opinionin tonë. Rreziku që një informacion i pasaktë me ndikim material që vjen si rezultat i mashtrimit të kalojë pa u zbuluar është më i madh se një i tillë që vjen si rezultat i gabimit, meqenëse mashtrimi mund të përfshijë bashkëpunimin me qëllim mashtrimin, falsifikimin, fshehjen me qëllim, paraqitje të gabuara, ose anashkalimin e sistemeve të brendshme të kontrollit.
- Marrim kuptim të sistemit të kontrollit të brendshëm përderisa zë peshë në procesin e auditimit me qëllim që të planifikojmë procedura auditimi të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllim që të shprehim një opinion në lidhje me efektshmërinë e sistemit të kontrollit të Shoqërisë.
- Vlerësojmë nëse politikat kontabël të përdorura janë të përshtatshme dhe vlerësimet kontabël dhe informacionet e shpalluara nga drejtimi në lidhje me to janë të arësyeshme.
- Gjykojmë nëse parimi kontabël i vijimësisë i përdorur nga drejtimi i Shoqërisë dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje ose rrethana që mund të hedhë dyshim domethënës në aftësinë e Shoqërisë që të ruajë vijimësinë. Nëse dalim në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, na kërkohet që të tërheqim vëmendjen, në raportin tonë të auditimit drejt atyre të dhënave në pasqyrat financiare që lidhen me këtë pasiguri, ose nëse këto të dhëna janë të papërshtatshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në evidencën e auditimit që kemi marrë deri në datën e raportit të auditimit. Sidoqoftë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të bëjnë që Shoqëria të reshtë së ekzistuari.
- Vlerësojmë paraqitjen në tërësi, strukturën, dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshi të dhënat në shënime shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që arrihet paraqitje e drejtë dhe e sinqertë.

Ne komunikojmë me ata që u është ngarkuar përgjegjësia për drejtimin e Shoqërisë, ndër të tjera në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit dhe në lidhje me gjetje të

rëndësishme, përfshirë çfarëdo mangësie domethënëse në sistemin e kontrollit të brendshëm që cilat i ndeshim gjatë procesit të auditimit.

Ne gjithashtu i dorëzojmë atyre të ngarkuar me përgjegjësinë e drejtimit të Shoqërisë një deklaratë që ne kemi zbatuar ç'është kërkesë etike me ndikim në lidhje me pavarësinë, dhe që ti përcjellim atyre informacion në lidhje me të gjitha marrëdhëniet dhe çështje të tjera që arsyeshëm mund të mendohet se kanë ndikim në pavarësinë tonë dhe aty ku kërkohet, masat parandaluese që kemi marrë.

Nga çështjet që u kemi përcjellë atyre të ngarkuar me përgjegjësinë e drejtimit të Shoqërisë ne përcaktojmë ato çështje që kanë patur rëndësinë më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale, dhe që për këtë arsye janë çështjet kyç të auditimit. Ne i përshkruajmë ato çështje në raportin e auditimit përveç nëse një ligj apo një rregullorë e ndalon bërjen publike të atyre çështjeve ose kur, në raste shumë të rralla, ne përcaktojmë që një çështje nuk duhet të publikohet në raportin tonë sepse pasojat negative nga kjo gjë do të vlerësohej në mënyrë të arsyeshme që do të tejkalonin përfitimet nga bërja publike e tyre.



Tiranë, 29 qershor 2022

ZLA Consulting shpk
Bledar KORKAJ
Auditor Ligjor

PKF Albania shpk
Taulant ASLLANI
Auditor Ligjor

Bledar Korkaj



Taulant Asllani



CONAD ALBANIA SH.P.K.

PASQYRAT FINANCIARE
per vitin ushtrimor
të mbyllur më 31 dhjetor 2021

(me Raportin e Audituesit te Pavarur)

PËRMBAJTJA

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.....	5
PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO.....	7
SHENIME SPIEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE	8-30

CONAD ALBANIA SHPK*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2021**

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë materiale	6	53,729,916	42,208,630
Aktivët afatgjatë jomateriale	7	14,756,193	10,852,622
Aktive afatgjatë materiale të investuara	8	162,486,791	171,038,728
Aktive me të drejtë përdorimi	9	58,393,765	84,346,540
Parapagime dhe shpenzime të shtyra afatgjatë	10	47,454,614	7,601,800
Pjesëmarrje në të tjera njësi	11	42,410,006	11,968,480
Totali i aktiveve afatgjatë		379,231,284	328,016,801
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë	12	147,912,055	146,952,330
Llogari të arkëtueshme tregtare	13	248,089,790	203,615,919
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	14	562,103,440	47,368,455
Llogari të arkëtueshme të tjera		2,248,281	3,711,873
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	15	198,217,786	95,634,795
Mjetet monetare në arkë e në bankë	16	387,078,857	668,715,277
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,545,650,208	1,165,998,649
Totali i aktiveve		1,924,881,492	1,494,015,450
KAPITALI			
Kapitali themeltar		151,426,642	151,426,641
Rezerva ligjore		15,142,664	15,142,664
Fitime të mbartura		262,164,418	198,641,092
Fitimi i ushtrimit		379,674,330	248,023,312
Totali i kapitalit		808,408,054	613,233,723
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë		-	-
Detyrime për qera financiare	17	32,324,191	61,381,293
Totali i detyrimeve afatgjatë		32,324,191	61,381,293
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	18	237,135,655	188,591,149
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	19	749,772,733	545,195,780
Detyrime për qira financiare	17	28,574,396	26,815,137
Të ardhura të shtyra	20	24,580,255	27,234,824
Detyrime tatimore	21	24,966,944	13,786,323
Llogari të pagueshme të tjera	22	19,119,263	17,777,221
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,084,149,246	819,400,434
Totali i detyrimeve		1,116,473,438	880,781,727
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,924,881,492	1,494,015,450

Shenimet shoqeruese mbi pasqyrat financiare nga 8 në 30 janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare

CONAD ALBANIA SHPK*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	23	3,803,506,806	3,394,599,031
Të ardhura të tjera	24	3,555,739	7,708,500
Total të ardhura		3,807,062,545	3,402,307,532
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	25	(3,058,790,605)	(2,792,282,739)
Shpenzime personeli	26	(101,082,887)	(104,480,466)
Shpenzime amortizimi		(55,013,288)	(51,746,422)
Shpenzime zhvlerësimi	27	(3,165,334)	(7,823,308)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	28	(142,795,350)	(139,147,988)
Total shpenzime		(3,360,847,464)	(3,095,480,923)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	29	(3,288,624)	(5,514,769)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	30	4,792,137	(6,414,761)
Fitimi para tatimit		447,718,595	294,897,079
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(68,044,264)	(46,873,767)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	31	(67,646,079)	(46,873,767)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		(398,185)	-
Fitimi i vitit		379,674,330	248,023,312
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		379,674,330	248,023,312

Shenimet shoqeruese mbi pasqyrat financiare nga 8 në 30 janë pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare

CONAD ALBANIA SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitimi para tatimit	447,718,595	294,897,079
Axhustime për zërat jo-monetare:	-	-
Amortizimi	55,013,288	51,746,422
Zhvlerësimi	3,165,334	7,823,308
Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi kapital	532,058	264,589
Zhvlerësim inventari	-	-
Shpenzime per interesa	3,288,624	5,514,769
Diferenca konvertimi te perealizuara	-	-
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues	-	-
Rënie/(ritje) në inventar	(959,726)	(9,336,348)
Rënie/(ritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(555,402,109)	337,877,551
Rritje/(rënie) në llogari të pageshme dhe të tjera	249,077,345	(99,911,506)
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	(2,654,569)	22,054,966
Rënie/(ritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(117,435,804)	(80,890,485)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	82,343,036	530,040,328
Interesa të paguara	(3,288,624)	(5,514,769)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(66,389,102)	(45,558,038)
	(69,677,726)	(51,072,807)
<i>Aktivitetet investuese</i>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(23,394,173)	(14,692,493)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	674,520	370,636
Investime në të tjera njësi	(30,441,526)	(459,799)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(53,161,179)	(14,781,655)
<i>Aktivitetet financuese</i>		
(Ripagim)/të hyra neto nga qeraja financiare	(31,640,552)	(24,823,896)
Te hyrat nga huatë afatgjata	-	-
Te hyrat/(ripagim) neto ne hua afatgjata	(25,000,000)	-
Pagesa dividendi	(184,500,000)	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(241,140,552)	(24,823,896)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(281,636,420)	439,361,986
Mjetet monetare në fillim të periudhës	668,715,277	229,353,291
Mjetet monetare në fund të periudhës	387,078,856	668,715,277

16

Shenimet shoqeruese mbi pasqyrat financiare nga 8 ne 30 jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

CONAD ALBANIA SHPK*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO**
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

	Kapitali themeltar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2020	151,426,642	15,142,664	-	198,641,106	365,210,397
Fitimi i vitit				248,023,312	248,023,312
Transferim në fitime të mbartura			198,641,106	(198,641,106)	-
Transferim ne rezerva ligjore					
Dividendë të shpërndarë					
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	151,426,642	15,142,664	198,641,106	248,023,312	613,233,724
Fitimi i vitit 2021				379,674,330	379,674,330
Transferim në fitime të mbartura			248,023,312	(248,023,312)	-
Transferim ne rezerva ligjore				-	-
Dividendë të shpërndarë			(184,500,000)	-	(184,500,000)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	151,426,642	15,142,664	262,164,418	379,674,330	808,408,054

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 ne faqe 30 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Keto pasqyra financiare jane miratuar nga Drejtimi, më 28.06.2022.

Artenida Dule
Artenida Dule
(Drejtues finance)

Alessandro Rosa
Alessandro Rosa
(Administrator)



CONAD ALBANIA SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqëria "Conad Albania" sh.p.k është regjistruar pranë QKB me datë 23.02.2012 me NIPT L21423017V. Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria operon në fushën e blerjes, dhënies me qira, shitjes së aktiviteteve tregtare me shumicë dhe pakicë dhe të veprave që kanë lidhje me këto aktivitete, si dhe import-eksport të mallrave të ndryshëm që do të jenë objekt i aktivitetit tregtar.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 151,426,642 lekë (1,084,100 EUR) i cili zotërohet nga ortakët e shoqërisë:

- Z. Luan Leka me 34 % të kuotave ose 368,594 EUR.
- Kompania E.H.W sh.p.k me 55 % të kuotave ose 596,255 EUR.
- Kompania Conad Adriatico Societa Cooperativa me 11 % të kuotave ose 119,251 EUR.

Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në autostradën Tiranë-Durrës, km.6 Kashar, Tiranë.
Administratori i shoqërisë është z. Alessando Rosa.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2021 është 60 punonjës (2020: 58 punonjës). Numri i punonjësve në fund të vitit 2021 i ndarë sipas kategorive është:

- 1 administrator
- 26 staf administrate
- 10 staf në shitje
- 23 staf në magazinim & logjistikë

PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së. Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, nëse ka të tilla.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve. Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive nga data 1 janar 2020 por ato nuk kanë patur ndryshime ne pasqyrat financiare te shoqërisë. Këto ndryshime janë paraqitur më poshtë:

- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021)
- Reforma e standardit të normës së interesit (IBOR) - ndryshimet në fazën 2 të SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 (lëshuar më 27 gusht 2020 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).

3.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të papërvetësuara

Një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të shoqërisë, janë paraqitur më poshtë:

- Ndryshimet në SNRF 3 për disa referenca nga ndryshimet e Kuadrit Konceptual (në fuqi më 1 janar 2022).
- Ndryshimet në SNK 37 "Provizionet, aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara" (në fuqi më 1 janar 2022).
- Ndryshimet në SNK 16 "aktivet afatgjata materiale" (në fuqi më 1 janar 2022).
- Ndryshimet në SNA 1 ne klasifikime (në fuqi më 1 janar 2023).
- Ndryshimet në shënimet për politikat kontabël (në fuqi më 1 janar 2023).
- Ndryshimet në SNK 18 "Politikat kontabël, vlerësimet dhe gabimet" (në fuqi më 1 janar 2023).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).

4. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të meposhtme janë aplikuar në menyre konsistente gjatë periudhës për të cilën janë përgatitur këto pasqyra financiare të ndermjetme, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

CONAD ALBANIA SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare të paraqitura në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është percaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kurset e këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e asetëve dhe detyrimeve monetare me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë:

Kursi i këmbimit	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
EUR/ LEK	120.76	123.70
USD / LEK	106.54	100.84

4.2 Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. **Instrumentat financiare – njohja fillestare.** Instrumentat financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentat e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlerë e dejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas ndalojes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare — klasifikimi dhe matjet pasuese — kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktive financiare — klasifikimi dhe matjet pasuese — modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrë se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen reziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

CONAD ALBANIA SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

Aktivitet financiarë — klasifikimi dhe matjet pasuese — karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për t'i shitur, kompania vlerëson çdo flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas.

Aktivitet financiarë — pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësitë ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paafësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivitet financiarë që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivitet financiarë - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivitet financiarë kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivitet financiarë ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare në ose më shumë njësitë ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitet financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitet financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiarë — kategoritë e matjes

Detyrimet financiarë klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiarë të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiarë të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiarë — çregjistrimi

Detyrimet financiarë çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiarë kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paafësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e

11

CONAD ALBANIA SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshkohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit. Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normen efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston të amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me koston të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiv.

CONAD ALBANIA SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4 Aktivitetet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostot përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostot e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e vmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostot e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostot e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
----------------------	----------------------	---------------------



CONAD ALBANIA SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.7 Qiratë


Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

4.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit perbehet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyre. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zera që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.



CONAD ALBANIA SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabel të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).
